



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01-29988, dt. 29 Maj 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, neneve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, neni 4, neni 5 paragrafi 1.2, neni 6 dhe neni 8 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, Vendimit Nr.08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me nr. prot: 400/01-8274, dt. 26 Shkurt 2026, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - *Parcela Komunale 2294-0, përkatësisht, byfeja e objektit të Teatrit "Istref Begolli" në sipërfaqen prej 71m² e cila është e destinuar për qiradhënie*, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 29 Maj 2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Nr. 27/2026

Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - Parcela Komunale 2294-0, përkatësisht byfeja e objektit të Teatrit "Istref Begolli" në sipërfaqen prej 71m² e cila është e destinuar për qiradhënie

I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të byfesë së objektit të Teatrit "Istref Begolli", përkatësisht sipërfaqes prej 71m² e identifikuar me certifikatën e pronës me numër 2294-0 pronë Komuna Pejë cila është e destinuar për qiradhënie në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, sipas Vendimit Nr.08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër protokolli 400/01-8274. dt. 26 Shkurt 2026.

Nr.	PRONARI Poseguesi	Nr. i Ngastrës	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Periudha
1.	Komuna Pejë	2294-0	Rr. "Aleksandër Moisiu"	71m ²	ZK Pejë	Qiradhënie	15 vite

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni komunal për vlerësimin e ofertave do të inicioj procedurën e tenderimit – ankandit publik, për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale - parcela komunale 2294-0, pronë komunale në Zonën Kadastrale në Pejë me sipërfaqe prej 71m², e cila është e destinuar për qiradhënie në afat prej pesëmbëdhjetë (15) viteve.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlerësuese, Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.

IV. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

